

STATUTI I SHOQERISE
“Royal Caribbean Investment”sh.p.k

Kreu I
Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni1:
Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më date 27.06.2023, n e Themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“Royal Caribbean Investment ”sh.p.k.**

Themelues te shoqërisë janë:

1-Znj. MONIA FAVIANA i datelindjes 18.07.1970 lindur ne ITALI Paderno Dugnano (MI) dhe banues ne ITALI Oliveto Lario (LC), via Rossini, 13, madhore dhe me pergjegjesi te plote per te vepruar, me numer te kartes se identitetit CA139885GR;
2-Z. GIANLUIGI MORETTI i datelindjes 03.07.1961 lindur ne ITALI Bergamo (BG) dhe banues ne ITALI Oliveto Lario (LC), via Rossini, 13, madhore dhe me pergjegjesi te plote per te vepruar, me numer pashaporte YB3088401;
3- Z. EDOARDO PITTARI i datelindjes 11.03.1999 lindur ne ITALI Desio (MI) dhe banues ne ITALI Oliveto Lario (LC), via Rossini, 13, madhore dhe me pergjegjesi te plote per te vepruar, me numer te kartes se identitetit CA20780DS;

Neni2:
Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Shoqeri qe administrojnë asetet e individeve dhe kompanive,investimet ne fushen financiare dhe imobiliare,konsulence per menaxhim korrekt strategjik dhe fiscal.Tregetia nderkombetare dhe zgjedhja e partnereve per bashkepunime dhe vende te reja prodhimi.

Neni3:
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afate.

Neni4:
Selia

Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Lagjja 14, Rruga Bajram Tusha, Zona Kadastrale 8516, Godine me nr. pasurie 10/48, DURRES.

Adresa e faqes së internetit të shoqërisë: royalcaribbeaninv@gmail.com

Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: royalcaribbeaninv@gmail.com

Kreu II
Kapitali

Neni5

Kapitali themeltar:

(1) Kapitali fillestar i shoqerise private “Royal Caribbean Investment sh.p.k do te jete 10.000 (Dhjet mij leke).Kapitali eshte 100 % nga kuotat e ortakeve , e ndare ne 3(tre) kuota

.Kontributi i ortakeve eshte vleresuar sipas te dhenave te meposhteme:

1. Znj. MONIA FAVIANA, eshte zoteruese e 1(nje) kuote, me 34% pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise me vleren 3400 (tre mije e katerqind) leke;

2. Z. GIANLUIGI MORETTI, eshte zoterues i 1(nje) kuote ,me 33% pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise me vleren 3300 (tre mije e treqind) leke ;

3. Z. EDOARDO PITTARI, eshte zoterues i 1(nje) kuote ,me 33% pjesmarrje ne kapitalin e shoqerise me vleren 3300 (tre mije e treqind) leke ; Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit:

Kapitali I shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet vendimeve te asambles se ortakeve.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet me vendim te asambles se ortakeve, te cilet marrin vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojne.

Neni 7

Transferim i kapitalit:

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen a po kalohen nëpërmjet:

Kontributit në kapitalin e shoqërisë;shitblerjes;trashëgimisë; ç)dhurimit;çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesë të kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres:

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakeve është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështje te më poshtme:

1. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
2. ndryshimet e statutit;
3. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
4. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
5. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
7. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë veprimtarisë;
8. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
9. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
10. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
11. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
12. miratimin e rregullave procedural të mblledhjeve;
13. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statutit.

Neni 9 Administrimi

Asambleja e Ortakeve emëron një ose më shumë persona fizikë si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Q.K.R.
Detyra e Administratorit te vetem i caktohet Znj. **MONIA FAVIANA**, me numer te kartes se identitetit CA139885GR

Neni10 Kompetencate Administratorit.

Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

1. Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura Asambleja e Ortakeve ;
2. Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
3. Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
4. Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Asambles se Ortakeve për miratim;
5. Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
7. Raportojnë përpara Asambles se Ortakeve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
8. Kryejnë detyrat e tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të njoftojnë Asamblen e Ortakeve, në rastet kur:

1. Sipas bilancit vjetor a raporaporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë se ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
2. Shoqëria propozon të shesë a po të disponojë në mënyrë tjetër raktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
3. Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Asambleja e Ortakeve mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni11 Përgjegjësia e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajet kryerë gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Ortakeve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administrator vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të pa rregullta. Administratori ka barren e proves për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit, Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare, kryen veprime të mëposhtme:

- U kthen ortakëve kontributet;
- U paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- U shpërndan aktivet shoqërisë;
- Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes
- financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- Jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e demit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrënë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të demit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i Ortaku të vetem nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesëpadisë kundëra administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV **Viti financiar-ekspertet**

Neni 12 **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13 **Ekspertet**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë të ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

KreuV
Prishja–riorganizimi I shoqërisë

Neni14
Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe:

- Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin esaj;
- Me vendim të Asambles se Ortakeve ;
- Me hapjen e procedurave të falimentimit;

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambles se Ortakeve.

Nëse Asambles se Ortakeve nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, Brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni15
Riorganizimi I shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë14.04.2012“Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni16
Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjisllacionit shqiptar.


Përsa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni17
Mosmarrëveshjet


Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin a po interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKET:

MONIA FAVIANA



GIANLUIGI MORETTI



EDOARDO PITTARI

